



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL ^{1 2}

(I përmbledhur)

Tiranë, më 05.02.2020, ora 14.00

Drejton mbledhjen
Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës :

1. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.1, datë 08.02.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për miratimin e Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”;

2. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr.2, datë 15.02.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”;

3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;

4. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”

5. Ngritjen e një grupi pune për hartimin e rregullores së brendshme lidhur me detyrat e këshilltarëve dhe personelit administrativ të Gjykatës së Lartë të caktuar për mbështetjen e veprimtarisë së Këshillit, për veprimet e ndryshme administrative, për krijimin dhe mbajtjen e regjistrave, dokumentacionit, protokollit, arkivave dhe për sistemin e administrimit të çështjeve, për të përmbushur angazhimin e deklaruar të KED-së 2019 në nenin 22 të Rregullores së Brendshme.

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja “d”, neni232 pika 2, neni 242 shkronja “c”) dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

² Bashkëlidhur procesverbalit, për qëllime të njohjes nga kushdo i interesuar, gjenden projektvendimet me relacionet përkatëse të cilat janë në rendin e ditës së kësaj mbledhjeje.

Marrin pjesë :

1. Ardian Dvorani (kryetar)
2. Vitore Tusha (zëvendës kryetare)
3. Fiona Papajorgji (anëtare)
4. Artta Marku (anëtare)
5. Miranda Andoni (anëtare)
6. Saida Dollani (anëtare)
7. Ludovik Dodaj (anëtar)
8. Fatjona Memçaj (anëtare)
9. Arjan Qafa (anëtar)
10. Marsida Xhaferllari (anëtare zëvendësuese)
11. Bilbil Mete (anëtar zëvendësues)
12. Nezir Gjoka (anëtar zëvendësues)

Merr pjesë, si vëzhgues i përhershëm :

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit
2. Nejla Peka, komisionere, e pajisur me autorizimin nr. 60 prot., datë 31.01.2020, lëshuar nga Avokati i Popullit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr.115/2016:

1. Katrin Treska, përfaqësues të Presidentit të Republikës, të pajisur me autorizimin nr. 446, datë 29.01.2020, lëshuar nga Presidenti i Republikës.
2. Korab Lita, zëvendëskryetar i Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si përfaqësues i opozitës në Kuvend.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, mbështetës me konsulencë në procesin e hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore të KED :

1. Agnes Bernhard, drejtuese e misionit EURALIUS;
2. Michelle Lakomy, këshilltare ligjore rezidente pranë OPDAT
3. Maniela Sota, përkthyesë për EURALIUS
4. Xhoana Kovaçi, përkthyesë për OPDAT

HAPET MBLEDHJA - ora 14.10

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaroi të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, informon se të gjithë anëtarët e Këshillit janë të pranishëm, po ashtu edhe anëtarët zëvendësues, me përjashtim të z. Nazmi Troka, i cili, në fakt, sipas komunikimit të zhvilluar ka vështirësi për të qenë sot i pranishëm për shkak të gjykimeve. Gjithsesi, në rastin e anëtarëve zëvendësues, është e drejta e tyre të marrin pjesë në mbledhje, nuk është çështje detyrimi.

Në lidhje me rendin e ditës, sipas dakordësisë në përfundim të mbledhjes së mëparshme, është e parashikuar të shqyrtohen të njëjtat çështje të rendit të ditës. Në vijim të diskutimeve të mbledhjes së kaluar Këshilli është në procesin e shqyrtimit të projektaktit për disa shtesa dhe ndryshime për Rregulloren e Brendshme për Funkcionimin e KED.

Këshilli informohet edhe se, për shkak të kohës shumë të shkurtër, ka qenë e pamundur përgatitja e procesverbalit të përmbledhur të mbledhjes së kaluar, proces që duhet të përfundojë sot sepse ka qenë mbledhje e gjatë, rreth 4 orë pa 10 minuta.

Anëtarët e Këshillit miratojnë vijimin e mbledhjes me të njëjtin rend dite.

Këshilli vijon punimet e mbledhjes sipas rendit të ditës, me shqyrtimin dhe diskutimin e nenit 6 të projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.1 datë 08.02.2019 “Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, për shtimin një pike “3” në nenin 18 të kësaj Rregulloreje.

Marsida Xhaferllari, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet thelbin e motiveve për propozimin e dispozitës së nenit 6 të projektvendimit, për shtesën e një pike 3 në nenin 18, “Komunikimi me publikun”, të Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e KED.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe shprehim mendimet e tyre në lidhje me përmbajtjen e nenit 6 të projektvendimit për shtesën e një pike “3” në nenin 18 të Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e KED.

Nejla Peka, merr fjalën dhe parashtron se në lidhje me këtë ndryshim të propozuar, institucioni i Avokatit të Popullit shpreh dakordësi. Nuk ka asgjë të keqe, nëse parashikohen kompetencat e kryetarit. Një prej tyre është edhe përfaqësimi në lidhje me të tretët. Nuk përbën ndonjë shqetësim që edhe kjo detyrë, për të përgatitur komunikatën, për të urdhëruar publikimin e saj, të mos jetë e shtjelluar në një pikë më vete. Gjithashtu, për sa i përket shqetësimit për fjalinë e fundit, të shprehur këtu nga disa prej anëtarëve, në fillim më lejoni

t'ju sqaroj se, në gjykimin tonë, nuk duhet përjashtuar, ndodh se njerëz jemi dhe bëjmë gabime. Nuk flasim për pasaktësi në logjikën juridike, mund të jetë një gabim i thjeshtë material, një datë apo një mbiemër i shënuar gabim. Ndodh vazhdimisht në mbledhje të këtyre natyrave ku duhet marrë një vendim apo duhet shprehur në lidhje me subjektet e treta. Kjo nuk përbën shqetësim dhe nuk ka nevojë që Këshilli të mblidhet. Mund të përdoret dhe një formë e njohur si vendimmarrje qarkulluese, qarkullohet me email, ku të shprehim mendimet, ashtu sikundër mund të bëjmë edhe në rastet e tjera. Në gjykimin tonë është i pranueshëm tërësisht si ndryshim dhe një propozim i drejtë.

Katrin Treska, merr fjalën dhe parashtron se propozimi në fakt është një element shumë i rëndësishëm për sa përket transparencës në komunikimin me publikun, si një ndër parimet bazë që do të udhëheqë punën e Këshillit. Nga ana jonë mbështetet, për sa kohë që komunikata duhet të reflektojë të gjithë diskutimet e anëtarëve në mbledhje nuk asnjë arsye që edhe para publikimit të saj anëtarët të mos japin një dakordësi. Për formën dhe afatet mund të saktësohen në dispozitë. Edhe lidhur me një mendim që nëse nuk ka pasur probleme nuk është e nevojshme të saktësohet më tej Rregullorja, në fakt ky akt ka për detyrë të parashikojë çdo situatë të mundshme. Ka pasur problematika apo jo, pastaj është çështje tjetër.

Korab Lita, merr fjalën dhe parashtron se rezervon të drejtën për të dhënë mendim për arsye se nuk kam qenë në mbledhjen e fundit dhe materialet sapo i morra me shkrim për ti shqyrtuar.

Agnes Bernhard (përkthen përkthyesja), merr fjalën dhe parashtron se është mjaft e rëndësishme çështja se kush është personi që ka detyrën për të përgatitur komunikatën sepse është shumë e rëndësishme ajo që do të komunikohet. Ne kemi zhvilluar diskutime në mënyrë të vazhdueshme edhe me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë sepse edhe ata përgatisin rregulloret e tyre të brendshme. Kemi bërë një lloj kërkimi edhe jashtë se si veprojnë në këto raste Këshilla të tjerë. Për t'iu dhënë një shembull në lidhje me këtë diskutim kemi parë se si vepron në Itali Këshilli i Lartë i Magjistraturës. Ata në rregullat e brendshme parashikojnë një zyrtar për komunikimet me shtypin, shpesh me përvojë si gazetar, i cili bën njoftimet për publikun. Ky zyrtar duhet të këshillohet me komisionin përkatës ose me mbledhjen e Këshillit. Pra është ky zyrtar që bën njoftimet për publikun. Ndërsa në Holandë rregullat e brendshme ia ngarkojnë këtë detyrë kryetarit të këshillit. Por ata këshillohen ose dakordësohen për formulimet e komunikatës dhe më tej e publikojnë njoftimin. Pra në parim, komunikimet me publikun të realizuara nga kryetari i këshillit janë një praktikë e mirë në Evropë. Shqetësimi i vetëm në lidhje me formulimin e

propozuar për miratim në rregullore është që kjo mos të jetë dhe mos të çojë në një procedurë burokratike. Problem është procedura që ka të bëjë me marrjen dhe reflektimin e mendimit të çdo anëtari. Mund të ndodhë që anëtarët të kenë opinione të ndryshme dhe të kundërta me njëra tjetrën dhe duke u kthyer në një veprim vendimmarrje, për këtë do të duhet që të organizojmë mbledhje dhe bisedime të tjera në mënyrë që të bien dakord për përmbajtjen konkrete të komunikatës. Duke pasur parasysh që Këshilli tashmë është mjaft i mbingarkuar me punë, për mua është e rëndësishme që të evitojmë edhe këtë mbingarkesë për punën tuaj. Sigurisht komunikata për publikun është shumë e rëndësishme dhe kjo kërkon konsultim dhe dakordësi mes anëtarëve. Por nëse duhet ta kemi pikërisht këtë formulim kështu të detajuar si në këtë propozim, për këtë jam në mëdyshje.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve, për propozimin e shtimit të pikës 3 në nenin 18 të Rregullores së Brendshme për Funksonimin e KED, shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për miratimin e propozimit, me riformulimin “*Komunikata për publikun përgatitet nga Kryetari i Këshillit, i cili ia përcjell për mendim anëtarëve. Pas marrjes dhe reflektimit të mendimit të tyre, Kryetari i Këshillit urdhëron publikimin e komunikatës brenda 24 orëve nga zhvillimi i mbledhjes.*”, votuan anëtarët **Vitore Tusha, Fiona Papajorgji, Arta Marku, Miranda Andoni dhe Arjan Qafa**. Për mosmiratimin e propozimit votuan anëtarët **Ardian Dvorani, Saida Dollani, Ludovik Dodaj dhe Fatjona Memçaj**. Me rezultatin e votimit 5 vota pro dhe 4 kundër, ky propozim me riformulimet e sipërcituara miratohet.

Këshilli vijon punimet me shqyrtimin dhe diskutimin në lidhje me përmbajtjen e nenit 7 të projektvendimit për shtesën e një fjalie në shkronjën “ç” dhe për shtimin e dy shkronjave “d” dhe “dh” në pikën 2 të nenit 19 të Rregullores së Brendshme për Funksonimin e KED.

Marsida Xhaferllari, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet thelbin e motiveve për propozimin e dispozitës së nenit 7 të projektvendimit, për disa shtesa të propozuara në pikën 2 të nenit 19, “Kompetencat e Kryetarit”, të Rregullores së Brendshme për Funksonimin e KED.

Anëtarët e Këshillit, diskutojnë dhe parashtrajnë argumentet e tyre në lidhje me propozimet e paraqitura për shtesa e sipërcituara në pikën 2 të nenit 19 të Rregullores së Brendshme për Funksonimin e KED.

Nejla Peka, merr fjalën dhe parashtron se në lidhje me shkronjën “ç” nuk besojmë se përbën problem që të përfshihet edhe në projektvendimin e paraqitur për ndryshimin e rregullave të funksionimit të këtij organi. Është në kuptimin e kompetencave në parashikim të përgjithshëm, pra çfarë i lind kryetarit si detyrë, si kompetencë, në zbatim të Rregullores së

funksionimit të KED-së dhe nuk përbën problem që të përfshihet edhe në pikën 4 ku specifikisht një nga kompetencat mund të jetë edhe kjo. Ajo që do të propozonim do të ishte riformulimi nga pikëpamja e teknikës ligjvënëse. Jam dakord me atë çka u tha këtu nga disa anëtarë të Këshillit, për sa i përket formave të komunikimit, pra mjeteve të komunikimit administrativ. Mund të jetë në formë elektronike pa qenë e nevojshme të formalizohet në një shkresë administrative për të dhënë kështu edhe një keqkuptim për sa i përket marrëdhënieve kryetar-relator dhe anasjelltas. Për sa i përket shtimit të shkronjës “d”, në fakt qartësisht neni 19 i ka përcaktuar kompetencat e kryetarit. Së pari, për sa i përket drejtimit dhe bashkërendimit në zbatim të Kushtetutës dhe legjislacionit në fuqi dhe po ashtu çfarë duhet të bëj në zbatim të këtyre kompetencave. Ndoshta mund të jetë e shkrirë në një nga këto parashikime ose në pikën 1 ose në pikën 2, pra të jetë e shkrirë. Sepse ajo çka garanton kjo shkronjë, si propozim, zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta, mund të jetë jo domosdoshmërisht ashtu sikurse është thënë këtu që zbaton ato çka parashikon neni 226, legjislacioni zbatueshëm, por është edhe në rastet kur i duhet të shprehë një gjykim të drejtë të paanshëm për një problematikë që mund të lindë edhe për shembull në rastet e konfliktit të interesit, e ka përcaktuar ligji, dhe do të duhet të shprehë një opinion, duke pasur parasysh legjislacionin në fuqi për këtë fushë veprimtarie. Për sa i përket shkronjës “dh”, patjetër është transpozim i drejtpërdrejtë i ligjit për organet kolegjiale, që kështu nuk ka asgjë të keqe që të jetë i përmendur edhe në rregulloren e funksionimit e kryesisht në nenin 19, kompetencat e kryetarit.

Katrin Treska merr fjalën dhe parashtron se propozimi mua më habiti pak pse nuk është më herët në Rregullore. Jo vetëm sepse lidhet direkt me nevojën e pasjes dijeni të relatorit për çdo shkresë që del dhe që kryetari ka vetëm kompetencën ta përcjellë dhe fakti që nënshkruan mbi siglimin e relatorit nuk do të thotë që e konfirmon, por ai përmbush detyrën e tij për ta përcjellë. Por mbi të gjitha më habiti për faktin pse një praktikë e tillë nuk është ndjekur, siç e dëgjova nga diskutimet, sepse është një detyrim që është përcaktuar nga Këshilli i Lartë i Arkivave, në vendimin nr. 4 të 2017-ës, që ka miratuar rregulla për njësimin e punës në dokumente në autoritete publike të Republikës së Shqipërisë dhe ku shprehimisht thuhet çdo shkresë që rri në arkivin dhe protokollin e institucionit duhet të jetë e sigluar nga personi që e ka konceptuar apo e ka kërkuar atë informacion. Kështu që do t’ju ftoja të gjithë ta konsultoni dhe këtë vendim të Këshillit të Arkivave sepse është i detyrueshëm për zbatim për të gjitha institucionet.

Agnes Bernhard (përkthen përkthyesja), merr fjalën dhe shprehet se përveç atyre pikave që shprehëm që janë në përputhshmëri me ligjin e organeve të qeverisjes së drejtësisë,

gjithashtu do të doja t'ju tërhiqja pak vëmendjen tek neni 99 paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Administrative ku parashikohet që aktet administrative duhet të përmbajnë firmën e drejtuesit të organit. Prandaj, po pyes veten në qoftë se ky parashikim a do ishte në përputhshmëri me këtë parashikim? Dhe përpos kësaj dhe në aspektin praktik këtu kemi pasur pak parasysh edhe analogjitë me organet e tjera kolegjiale në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe e kemi parë se kush i firmos në fakt dokumentet dhe në fakt është kryetari i organit kolegjial që i firmos. Logjika pas kësaj është për ti mbajtur gjërat sa më të thjeshta dhe për të shmangur burokracinë e tepërt.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve, për propozimin e dispozitës së nenit 7 të projektvendimit, për disa shtesa të propozuara në pikën 2 të nenit 19, “Kompetencat e Kryetarit”, të Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e KED, shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë:

Për miratimin e propozimit të shtesës së një fjalie në shkronjën “ç” të pikës 2 të nenit 19 të Rregullores së Brendshme votoi anëtarja **Miranda Andoni**. Për mosmiratimin e propozimit votuan anëtarët **Ardian Dvorani, Vitore Tusha, Fiona Papajorgji, Arta Marku, Saida Dollani, Ludovik Dodaj, Fatjona Memçaj dhe Arjan Qafa**. Me rezultatin e votimit 1 votë pro dhe 8 kundër, ky propozim nuk miratohet.

Për propozimin e shtesës së shkronjës “d” në pikën 2 të nenit 19 të Rregullores së Brendshme të gjithë anëtarët e Këshillit votuan për mosmiratimin e propozimit.

Për miratimin e propozimit të shtesës së shkronjës “dh” në pikën 2 të nenit 19 të Rregullores së Brendshme votuan anëtarët **Arta Marku, Fatjona Memçaj dhe Arjan Qafa**. Për mosmiratimin e propozimit votuan anëtarët **Ardian Dvorani, Vitore Tusha, Fiona Papajorgji, Miranda Andoni, Saida Dollani dhe Ludovik Dodaj**. Me rezultatin e votimit 3 vota pro dhe 6 kundër, ky propozim nuk miratohet.

Këshilli vijon punimet me shqyrtimin dhe diskutimin në lidhje me përmbajtjen e nenit 8 të projektvendimit për shtimin e pikës 2 në nenin 22, “Regjistrat, dokumentacioni dhe administrimi i çështjeve”, të Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e KED.

Marsida Xhaferllari, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet thelbin e motiveve për propozimin e dispozitës së nenit 8 të projektvendimit, për shtesën e pikës 2 në nenin 22, “Regjistrat, dokumentacioni dhe administrimi i çështjeve”, të Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e KED.

Anëtarët e Këshillit, diskutojnë dhe parashitrojnë argumentet e tyre në lidhje me propozimin e paraqitur në dispozitën e nenit 8 të projektvendimit, për shtesën e pikës 2 në nenin 22 të Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e KED.

Nejla Peka, merr fjalën dhe parashtron se propozimi për ndryshimin e dispozitës aktuale ka të bëjë pikërisht me dhënien dhe krijimin e mundësisë së aksesit të duhur për Avokatin e Popullit, të cilit, Kushtetuta i ka njohur jo vetëm rol proaktiv në garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, por në të njëjtën kohë i ka njohur edhe një status të posaçëm të monitoruesit dhe vëzhguesit të ecurisë së Reformës në Drejtësi. Një rol specifik ky që jo rastësisht Kushtetuta ia ka dhënë. Është e vërtetë që rregullat bëhen për të garantuar zbatimin korrekt të normës kushtetuese në praktikë dhe, në këtë rast, me lejoni që të ndalem pak nga pikëpamja teorike se çdo të thotë të gëzosh kompetenca të monitorimit dhe vëzhgimit. Shpesh herë koncepti i monitorimit mbivendoset me atë të vëzhgimit, që do të thotë monitorimi është proces më i gjerë dhe në të shumtën e rasteve e përfshin vëzhgimin. Referuar përcaktimit që i bëhet në literaturën bashkëkohore e në jurisprudencë konceptit të vëzhgimit apo statusit të vëzhguesit, ai përkufizohet si aftësia që gëzon një organ për ti kushtuar më shumë vëmendje në mënyrë të posaçme gjerave dhe për ti vërejtur më shumë këto gjera nga ç ‘mund ti vërejnë njerëzit e tjerë apo organet e tjera. Zakonisht të qenit me statusin e vëzhguesit pranë një organi të administrimit, siç është në këtë rast KED-ja dhe Avokati i Popullit me rolin e vëzhguesit pranë këtij organi, procesi i vëzhgimit të Avokatit të Popullit përfshin disa qëllime. Qëllimi i parë është gjenerimi i provave empirike për të bërë një analizë të mbarëvajtjes së punës së organeve që zbatojnë pikërisht reformën në drejtësi, në kohë të caktuar, në një vend të caktuar. Së dyti për të mbështetur çdo përpjekje që bëhet për mirëadministrimin e punës dhe veprimtarisë administrative të këtyre organeve dhe në të njëjtën kohë për të qenë pararojë për sa i përket reformimit të veprimtarisë administrative të tyre. Dhe së treti për të dhënë dhe komunikuar shqetësime, sepse i është dhënë kjo e drejtë pikërisht për statusin dhe rolin specifik që gëzon nga Kushtetuta, në lidhje me çështje të caktuara të cilat organe apo individë të thjeshtë nuk i vërejnë. Parimet e vëzhgimit përfshijnë në fakt disa elementë dhe koncepte kyçe që lidhen me parimet që në të njëjtën kohë janë dhe parime kushtetuese. Paanshmëri, transparencë, përgjegjshmëri, pavarësi si dhe konstruktivitet në çdo mendim a gjykim që i fal në këtë rast statusi i të qenit vëzhgues. Vëzhgim do të thotë kryesisht të jesh i pranishëm në mbledhjet e organit, të luash një rol proaktiv dhe për këtë qëllim ta ndjekësh nga afër veprimtarinë e tij administrative, por edhe të gjykosh pikërisht nga kompetenca e vëzhgimit çdo hap, veprim procedural që ky organ zbaton gjatë veprimtarisë së tij administrative. Ndaj duke qenë që Avokati i Popullit, si garant dhe mbrojtës i të drejtave dhe lirive themelore të individit dhe në këtë rast ky rol i njohur nga Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi e pajis atë me një rol specifik tepër të veçantë, gjykojmë që aksesit që vetë Kushtetuta ia ka lejuar Avokatit të Popullit për të qenë vëzhgues i

imtësishëm në çdo hap të ecurisë së zbatimit të kësaj reforme, e gjykoj me vend propozimin. Dakord për një riformulim, pjesa e anëtarëve është e kuptueshme, por ne do të sugjerim në mënyrë të dedikuar të jetë një pikë brenda këtij neni për t'ia garantuar zbatimin korrekt të normës kushtetuese në praktikë nëpërmjet këtij rregullimi për sa i përket rolit kyç që luan ky institucion kombëtar i mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Katrin Treska merr fjalën dhe parashtron se duke parë propozimin, ashtu dhe duke dëgjuar qëndrimin e shumicës së anëtarëve që, në fakt, e quajten, e vlerësuan propozimin e bërë sikur krijon një frymë mosbesimi për diçka që është e garantuar si nga ligji dhe nga Kushtetuta, qoftë për anëtarët ku është e kuptueshme por dhe për Avokatin e Popullit, nuk shoh asgjë të keqe që ky propozim të miratohet për sa kohë edhe teknika legjislative që është përdorur në hartimin e kësaj Rregulloreje lejon specifikimin e momenteve të caktuara që ligji dhe Kushtetuta i njeh. Kështu që do të ishte mirë që të miratoheshin.

Korab Lita merr fjalën dhe parashtron se mendoj që nisur edhe nga diskutimet që u bënë, për anëtarët nuk do të ishte e nevojshme ky rregull sepse vetë statusi i tyre ua garanton këtë akses. Për sa i përket institucionit të Avokatit të Popullit e mendoj të arsyeshme dhe të nevojshme të miratohet.

Agnes Berhard (*përkthen përkthyesja*), merr fjalën dhe shprehet se shkurtimisht, meqenëse shumë nga argumentet u shprehën nga parafolësit, sigurisht jam dakord që një anëtar jo vetëm ka të drejtë por madje është i detyruar që të ketë akses në dosje dhe të njihet me materialet. Pra mendoj se nuk ka nevojë për rregullim tjetër. Për sa i takon rolit të Avokatit të Popullit, për të cilin gjerësisht është diskutuar edhe në Këshillin e mëparshëm, dëshiroj të përsëris pozicionin e EURALIUS-it. Bazuar në Kushtetutë, roli i Avokatit të Popullit është vëzhgues, në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Dhe në fakt nuk ka asnjë listim konkret se cilat janë ato veprime që mund të qartësojnë në mënyrë të mëtejshme se çfarë duhet të bëj e nuk duhet të bëj një vëzhgues. Megjithatë për këtë duhet të marrim parasysh se ligji na jep disa elementë për të kuptuar se çfarë përfshihet dhe çfarë jo. Nga ky interpretim të vjen përfundimi se një vëzhgues nuk është anëtar i Këshillit, nuk është as anëtar me të drejtë vote. Ka një ndryshim ndërmjet anëtarit dhe vëzhguesit. Sipas ligjit të kemi parasysh gjithashtu që Avokati i Popullit merr pjesë në mbledhje pa të drejtë vote, ndërkohë që anëtarët e KED janë ata që votojnë, kanë të drejtë vote. Gjithashtu, përveç kësaj, ka edhe dispozita të tjera që të japin disa indikacione, më konkretisht ato mbi kompetencën e gjykatave në procesin e kontrollit, shqyrtimit gjyqësor të rasteve, sipas të cilave ka një trupë gjyqësore që gjykon mbi gabimet procedurale dhe që ka akses në të gjitha aktet e çështjes për ta shqyrtuar nga këndvështrimi ligjor. Nisur nga ky

arsyetim mund të vijmë në përfundimin se kjo që as kjo nuk është një kompetencë e Avokatit të Popullit. Pra është mjaft e nevojshme dhe duhet të bëjmë një interpretim të pozicionit të Avokatit të Popullit si një vëzhgues sepse nuk kemi të përcaktuar kufij të qartë në ligj se cilat janë veprimet që mund të bëj ai si vëzhgues në praktikë. Por, gjithsesi nuk është në pozitën e rishqyrtuesit dhe as në pozitën e anëtarit, madje as edhe të anëtarit pa të drejtë.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve, për propozimin e dispozitës së nenit 8 të projektvendimit, për shtesën e pikës 2 në nenin 22, “Regjistrat, dokumentacioni dhe administrimi i çështjeve”, të Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e KED, shprehën qëndrimin dhe **votuan unanimisht** për mosmiratimin e propozimit.

Këshilli vijon punimet me shqyrtimin dhe diskutimin në lidhje me përmbajtjen e nenit 9 të projektvendimit për propozimin e shtimit të nenit 22/1 në Rregulloren e Brendshme për Funkcionimin e KED.

Marsida Xhaferllari, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet thelbin e motiveve për propozimin e dispozitës së nenit 9 të projektvendimit, për shtimin e nenit 22/1 në Rregulloren e Brendshme për Funkcionimin e KED.

Anëtarët e Këshillit, diskutojnë dhe parashtojnë argumentet e tyre në lidhje me propozimin e paraqitur për shtimin e nenit 22/1 në Rregulloren e Brendshme për Funkcionimin e KED.

Nejla Peka, merr fjalën dhe parashtron se propozimin do ta shikonim në një këndvështrim tjetër për sa i përket idesë që përcjell. Është gjë e mirë kur në tekniken legjislativë, pra në draftimin e akteve normative, një nga metodologjitë e punës është pikërisht vlerësimi i ndikimit, i *impact assessment*, e cila është e përbërë nga tre faza *ex ante* faza e zhvillimit dhe *ex post*. Pikërisht faza e fundit ka të bëjë me *final review*, rishikimin që i behet legjislacionit, akteve rregullative kur ato kanë hyrë në fuqi dhe kanë filluar të prodhojnë pasoja juridike për të tretët apo dhe për vetë organin. Nga kjo pikëpamje, ideja e hedhur në këtë propozim është absolutisht revolucionare për KED sepse nëse ne nuk kemi teknikën ligjvënëse një metodologji të vlerësimit të ndikimit për mënyrën se si përkthehen politikat në legjislacion, në këtë kontekst KED bën një hap përpara nga organet e tjera sepse pranon rishikimin e çdo vendimmarrje, bazuar rregullat e miratuara prej këtij organi, për mënyrën se si janë zbatuar dhe ku ka ceduar, por edhe për të pranuar, pa dashur të biem ndesh me parimin *bias judgement*, paragjykimin në gjykim, edhe për mënyrën se si kanë raportuar të tretët veprimtarinë e KED-ës. Nuk ka asgjë gjë të keqe që gjithçka që gjeneron progres nga kjo pikëpamje të përkthehet edhe në këtë lloj forme për rishikimin e vendimmarrjes së KED .

Katrin Treska merr fjalën dhe parashtron se nuk kam asgjë për ti shtuar asaj që parashtroj zj. Peka. Në fakt çdo akt ligjor dhe nënligjor duhet ti nënshtrohet analizës *ex ante* dhe *ex post*. Kjo është e vetmja mënyrë për të arritur në ndryshime të tjera për adresimin problematikave që mund të kenë treguar zbatimi i akteve një vit me parë dhe kjo në asnjë rast nuk do të thotë që hedh punën poshtë të anëtarëve të një këshilli të mëparshëm .

Korab Lita merr fjalën dhe parashtron se në funksion të vazhdimësisë së punës, të mos ndërprerjes, por edhe të përmirësimit të herë pas hershëm të punës, mendoj se është krejt normale dhe mund të pranohet propozimi.

Agnes Bernhard (*përkthen përkthyesja*), merr fjalën dhe shprehet se do të qëndroja pak përsëri në çështjen e burokracisë. Nuk do të këshilloja të pranohet një automatizim. Mund të ketë situata kur të gjithë amtarët e këshillit të jenë të kënaqur me rregullat dhe me mënyrën se si ato janë ndërtuar dhe nuk do doja që kjo të shfaqej si një formë detyrimi për këshillin që duhet ta bënte në çdo rast, pra mund të ishte si mundësi, jo si një detyrim diskutimi mbi rishikimin e rregullave. Gjithashtu do të isha më e interesuar që këshilli të qasej në drejtim të atyre detyrave që këshilli i mëparshëm nuk ka mundur ti përfundojë dhe që kanë mbetur të hapura, si për shembull shqyrtimet dhe vendimet për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve. Këto janë çështje që kanë urgjencë dhe më shumë rëndësi për tu trajtuar dhe menaxhuar nga këshilli i ri krahasuar me fillimin e punës menjëherë me rishikimin e rregullave nënligjore. Këtë do ta bëja nëse këshilli e gjen se do të ishte e nevojshme dhe vendos që ta realizojë.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve, për propozimin e dispozitës së nenit 9 të projektvendimit, për shtimin e nenit 22/1 në Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e KED, shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për miratimin e propozimit votuan anëtarët **Arta Marku, Fatjona Memçaj dhe Arjan Qafa**. Për mosmiratimin e propozimit votuan anëtarët **Ardian Dvorani, Vitore Tusha, Fiona Papajorgji, Miranda Andoni, Saida Dollani dhe Ludovik Dodaj**. Me rezultatin e votimit 3 vota pro dhe 6 kundër, ky propozim nuk miratohet.

Anëtarët e Këshillit, votojnë unanimit për nenin 10 të projektvendimit mbi hyrjen në fuqi të këtij vendimi menjëherë dhe publikimin e tij në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pas përfundimit të diskutimit dhe votimit për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.1 datë 08.02.2019 “Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit të Emërimeve në

Drejtësi”, si edhe pas këshillimit me pjesëmarrësit, për shkak edhe të nevojave të teknikës së regjistrimit audio të punimeve të mbledhjes, cakton 20 minuta pushim.

PJESA E DYTË E MBLEDHJES

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pas pushimit, sipas rendit të ditës, orienton vijimin e punimeve të mbledhjes me shqyrtimin dhe diskutimin e projektvendimit “*Për një shtesë në vendimin nr. 2, datë 15.02.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”*”. Gjithashtu, informohet Këshilli se, sikurse është bërë e njohur mbledhjen e kaluar, anëtarja Fatjona Memçaj ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga pjesëmarrja në diskutime dhe vendimmarrje për të projektvendimet në shqyrtim për shtesa dhe ndryshime në aktet nënligjore normative të KED, për shkak se njëra nga kandidatet, është njeriu i afërm i saj. Ky rast ka ndodhur edhe vitin e kaluar për të njëjtën shkak sepse për ko incidencë kandidate ka qenë i njëjti person në vakancat e tjera në shqyrtim nga KED i vitit 2019. Heqja dorë është miratuar, prandaj në vend të anëtares Fatjona Memçaj, sikurse e parashikon ligji dhe aktet tona nënligjore, me të drejtën e plotë si për të dhënë mendim ashtu edhe për të votuar për këto tre projektvendime është anëtari zëvendësues Nezir Gjoka.

Marsida Xhaferllari, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet në mënyrë të përmbledhur qëllimin dhe arsyet e ndërmarrjes së nismës për propozimin e këtij projektvendimi për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli, me të cilin propozohet vetëm një shtesë, pas pikës 5 të vendimit nr. 2, datë 15.02.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “*Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion*”, të shtohet pika 5/1.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe shprehin mendimet e tyre në lidhje me përmbajtjen e nenit 1 të projektvendimit për shtesën e pikës 5/1 pas pikës 5 të vendimit nr. 2, datë 15.02.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Nejla Peka, merr fjalën dhe parashtron se jam plotësisht dakord me propozimin. Ky është rasti kur ne rishikojmë edhe një herë aktet, kur vëmë re se ka boshllëqe apo situata të pa parashikuara.

Katrin Treska merr fjalën dhe parashtron se është dakord me projektvendimin.

Agnes Bernhard (përkthen përkthyesja), merr fjalën dhe shprehet se nuk ka koment të mëtejshëm përtej atyre që parashtruan pjesëmarrësit e tjerë.

Anëtarët e Këshillit, votojnë unanimitisht për miratimin e nenit 1 të projektvendimit për shtesën e pikës 5/1 pas pikës 5 të tij.

Anëtarët e Këshillit, votojnë unanimitisht për nenin 2 të projektvendimit mbi hyrjen në fuqi të këtij vendimi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, sipas rendit të ditës, orienton vijimin e punimeve të mbledhjes me shqyrtimin dhe diskutimin e projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë””.

Marsida Xhaferllari, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet në mënyrë të përmbledhur qëllimin dhe arsyet e ndërmarrjes së nismës për propozimin e këtij projektvendimi për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli, duke vijuar me paraqitjen e thelbit të motiveve për propozimin e dispozitës së nenit 1 të projektvendimit, për heqjen e fjalëve “e të sekretit shtetëror” në pikën 2 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe shprehim mendimet e tyre në lidhje me përmbajtjen e nenit 1 të projektvendimit për heqjen e fjalëve “e të sekretit shtetëror” në pikën 2 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Gjatë diskutimit mes anëtarëve, paraqitet në mbledhje Avokatja e Popullit, Erinda Balanca .

Pas diskutimit të anëtarëve dhe anëtarëve zëvendësues, ftohen të marrin fjalën pjesëmarrësit e tjerë në mbledhjen e Këshillit.

Erinda Ballanca, merr fjalën dhe parashtron se unë kanë qenë në KED gjatë gjithë kohës dhe KED nuk ka pasur asnjë rast personi të përgjuar dhe për këto efekte të jetë përjashtuar. Pra nuk ka pasur një rast konkret që të ketë pasur persona në përgjim apo ndonjë person i cili të ketë pasur ndonjë rekord të kësaj natyre. Ne mund të kemi pasur anëtarë të KED që mund të kenë qenë nën përgjim dhe kjo është histori tjetër. Ne nuk kemi pasur, në informacionin tonë, asnjë person që të ketë pasur ndonjë problem të tillë me ligjin. Unë jam e sigurt për vendimmarrjet që kemi marrë dhe kam pyetur rast pas rasti nëse nga prokuroria ka të dhëna që ndonjë nga personat tanë kanë qenë nën hetim. Kjo nuk ka ndodhur. Mund ta kemi skualifikuar për ndonjë gjë tjetër, për këtë nuk e kemi skualifikuar. Në qoftë se kjo gjë ka ndodhur sepse ka qenë një sekret shtetëror kjo është një gjë tjetër. Kështu që sigurisht ata persona që e kanë informacionin mund ta bëjnë. Qëllimi i kësaj norme nuk është të garantoj

sekretin shtetëror. Po bëjmë një rregullore për të treguar se cilat janë rregullat dhe çfarë garancie do tu japim ne kandidatëve. Ata të cilët përgjohen dhe që gjenden fajtor sigurisht që kanë për tu dënuar. Ne këtu nuk ju tregojmë të gjithë njerëzve të drejtën e ankimit në gjykatë, për shembull, sepse dihet se ka rregulla që çdokush i cili akuzohet ka të drejtën e ankimit në gjykatë dhe nuk e themi këtë gjë këtu, në mënyrë specifike. Këtu kemi vetëm disa rregulla dhe parime bazë që, në gjykimin tim, janë të rëndësishme për tu përfshirë dhe treguar frymën e këtij rregullimi, të këtij vendimi që është akt normativ i KED. Pra ne tregojmë cilat janë parimet thelbësore administrative dhe kjo është më tepër garanci ndaj aplikuesit. Ajo që ne bëjmë në këto dispozita të përgjithshme është se mundoheni që ti japim garanci të tretëve për procesin tonë. Nuk jemi këtu për ti dhënë garanci organeve ligjzbatuese që ne e kemi përcaktuar këtu edhe sekretin shtetëror sepse ajo është e përcaktuar në ligj.

Katrin Treska merr fjalën dhe parashtron se ne e mbështesim propozimin e projektvendimit, aq me shumë që një parashikim i tillë nuk e ka vendin tek dispozitat e përgjithshme të rregullores dhe aq më pak tek parimet. Por meqenëse u përmenden edhe vendimet e GJEDNJ, rasti i Polonisë të cilën unë e kam lexuar me shumë vëmendje dhe dua ta sjell edhe në vëmendje anëtarëve, është një rast i vjetër dhe nuk më kujtohet emri, por është një vendim i vjetër i GJEDNJ. Ndërkohë që, vitet e fundit, është rritur numri i vendimeve që iu kërkojnë autoriteteve shtetërore të verifikojnë paraprakisht nëse kërcënimet për sigurinë kombëtare janë të mbështetura apo jo dhe kanë ngushtuar vendimmarrjen e gjerë shtetërore për ruajtjen e informacionit të klasifikuar. Mund të përmendim disa nga këto vendime që jam e familjarizuar por ka dhe shumë të tjera: *Malone vs. UK*,*Bucur & Toma vs Romania*.

Agnes Berhard (*përkthen përkthyesja*), merr fjalën dhe shprehet se, ndërkohë që anëtarët diskutonin, e kërkova vendimin përkatës që ju (kryetar) e trajtuat dhe ky është vendimi i GJEDNJ *Regner vs. Czech Republic* i datës 19.09.2017. Është një vendim që kishte të bënte me një çështje nëse në një procedurë administrative mund të përdorësh informacion të klasifikuar. GJEDNJ shprehet se, meqenëse vetë organi ka akses të pakufizuar në të gjitha dokumentet e klasifikuar dhe ata ishin në pozitën për të gjykuar e vendosur nëse për këto dokumente duhet ti jepej apo jo akses edhe palës tjetër, kjo nuk përbën shkelje të parimit të gjykimit të drejtë. Pra nga GJEDNJ pranohet përdorimi i informacioneve të klasifikuara nëse edhe vetë gjykata do të kish akses në këto informacione të klasifikuara.

Marsida Xhaferllari merr fjalën dhe parashtron një pyetje për ekspertin. Me parantezën që unë personalisht nuk jam kundër të mblidhen informacione të tilla, dua ta theksoj këtë se kam përshtypjen se po keqkuptohet diskutimi që po bëj. Jam plotësisht e qartë

mbi të gjitha parashikimet kushtetuese dhe ligjore. A besoni ju që qasja duhet të jetë se rregulli është informacion sekret apo duhet të jetë si përjashtim informacioni sekret? Sepse unë besoj se duke e vendosur këtë parashikim si një rregull e jo përjashtim në dispozita parimore jepet një mesazh shumë i fortë se KED vepron bazuar në informacione sekrete.

Agnes Berhard (përkthen përkthyesja), merr fjalën dhe përgjigjet që, nëse e kuptova drejt ju keni ndjesinë se KED ka mendimin që mund të vendosë bazuar në informacione të klasifikuara dhe kjo është shkelje e parimit të gjykimit të drejtë. Edhe Kodi i Procedurës Administrative tashmë i referohet si i tillë parimit të sekretit shtetëror. Nuk e gjej të çuditshme këtë në vendimin e KED, sikurse referohen aty edhe parimet e tjera. Pra nuk e gjej përmendjen në rregulloret e tij si të papërshtatshëm. Për aq kohë sa garancitë e treguara nga GJEDNJ në këtë vendim të respektohen mendon se nuk ka ndonjë çështje për respektimin e standardeve evropiane.

Erinda Ballanca, merr fjalën dhe parashtron se për të sqaruar edhe njëherë konceptin, për mua, sikurse propozohet duhet të ishte mirë që KED ta hiqte. E vini apo nuk e vini mua nuk më bie bota, personalisht. Pse e them këtë? Nëse ka mundësi që ne të përmirësojmë elemente të rregullores, kjo është shumë e rëndësishme. Thelbi i diskutimit të znj. Bernhrad ishte se Gjykata ka thënë që organet administrative mund të përdorin dhe informacione të tjera të klasifikuara në marrjen e një vendimi për sa kohë që përmbajtja e këtyre informacioneve mund të nënshtrohet vlerësimit të gjykatës. Ne këtu nuk e kemi këtë mundësi. Të jemi të qartë se Kodi jone nuk jep mundësinë që gjykata ta shikojë. As individit dhe as gjykata nuk ka mundësi të shikojë nëse vendimmarrja e KED, e marrë mbi bazën një vendimi të klasifikuar, ka qenë i drejtë apo jo. Për ta kuptuar ligji jonë nuk e lidh me informacionin klasifikuar të drejtën e ankimit. Të drejtën e ankimit të një kandidati të përjashtuar nga një e dhënë si informacion të klasifikuar gjykata e hedh poshtë sepse nuk është shkelje e rreth procedurale, për sa kohë që është sekret. Pra nuk do të ketë fare një *review* nga gjykata ndaj kësaj vendimmarrje administrative. Prandaj ky parim i rëndësishëm i GJEDNJ, në rastin konkret, nëse ne edhe e rithemi këtu, e pengon apo e ul edhe numrin e atyre pak kandidatëve që ne mezi po e presim, që e humbin besimin tek procesi, përveç faktit që kemi shumë pak candidate që vijnë të kandidojnë nëse e shtojmë edhe një here elementin e sekretit shtetëror. Parimet bazë të punës së KED-së janë të shkruara në ligj dhe neni 229 është i qartë për këtë. Shtimi i elementeve të tjerë nuk e përmirëson, por e përkeqëson tekstin.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve, për propozimin e heqjes së fjalëve “e të sekretit shtetëror” në pikën 2 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit për Emërime

në Drejtësi, shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për mosmiratimin e propozimit **votuan të gjithë anëtarët e Këshillit.**

Këshilli vijon punimet me shqyrtimin dhe diskutimin në lidhje me përmbajtjen e nenit 2 të projektvendimit për shtesën e pikës 4/1 pas pikës 4 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Marsida Xhaferllari, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet thelbin e motiveve për propozimin e dispozitës së nenit 2 të projektvendimit për shtesën e pikës 4/1 pas pikës 4 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Anëtarët e Këshillit, diskutojnë dhe parashtrojnë argumentet e tyre në lidhje me propozimin e paraqitur për shtesën e pikës 4/1 pas pikës 4 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve për propozimin e shtimit të pikës 4/1 pas pikës 4 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për miratimin e propozimit **votuan të gjithë anëtarët e Këshillit.**

Këshilli vijon punimet me shqyrtimin dhe diskutimin në lidhje me përmbajtjen e nenit 3 të projektvendimit për shtesën e pikës 5/1 pas pikës 5 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Marsida Xhaferllari, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet thelbin e motiveve për propozimin e dispozitës së nenit 3 të projektvendimit për shtesën e pikës 5/1 pas pikës 5 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Anëtarët e Këshillit, diskutojnë dhe parashtrojnë argumentet e tyre në lidhje me propozimin e paraqitura për shtesën e pikës 5/1 pas pikës 5 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Erinda Ballanca, merr fjalën dhe parashtron se nuk kam komente për këtë propozim.

Katrin Treska merr fjalën dhe parashtron se e vlerëson të nevojshëm këtë saktësim të propozuar.

Agnes Bernhard (përkthen përkthyesja), merr fjalën dhe shprehet se sigurisht besoj që duhet të përcaktohet se çfarë ndodh me rregullat kur këshilli nuk arrin që të përfundojë të gjitha punët dhe detyrat e tij brenda mandatit. Gjithashtu, për hir të efikasitetit të procedurave, unë do të kërkoja të merrej në konsideratë opsioni se ai që ka qenë relator në një mandat të vazhdojë edhe në mandatin tjetër, në qoftë se do të rizgjidhet nga shorti në këshill.

Mendoj edhe se dispozita duhet të riformulohet në atë mënyrë që jo domosdoshmërisht duhet të kemi një relator të ri dhe që ky relator duhet ta fillojë punën nga e para, por mund të marrë ose mund të vazhdojë punën e relatorit të mëparshëm, të mandatit të mëparshëm dhe të vazhdojë më tej vetëm nëse gjykon se verifikimi ka qenë jo i plotë dhe është e nevojshme që të bëhen verifikime të mëtejshme përtej punës që ka bërë relatori i mëparshëm.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve, për propozimin e dispozitës së nenit 3 të projektvendimit për shtesën e pikës 5/1 pas pikës 5 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë:

Për miratimin e propozimit me këto riformulime:

“5/1. Kur veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit nuk kanë përfunduar gjër më 31 dhjetor, atëherë relatori i ri kontrollon saktësinë dhe plotësinë e veprimeve të kryera për të përfunduar me përparësi këtë fazë, duke konsideruar respektimin e afatit ligjor.

5/2. Kur relatori i ka përfunduar veprimet procedurale dhe verifikuese, por Këshilli nuk ka shqyrtuar çështjen gjër më 31 dhjetor, atëherë relatori i ri, pasi kontrollon saktësinë dhe plotësinë e veprimeve të kryera:

a) konfirmon procedurën e ndjekur dhe përcjell relacionin e hartuar prej tij për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit;

b) vijon kryerjen e veprimeve procedurale dhe verifikuese shtesë.”

votuan anëtarët **Ardian Dvorani, Vitore Tusha, Fiona Papajorgji, Arta Marku, Miranda Andoni, Fatjona Memçaj** dhe **Arjan Qafa**.

Për mosmiratimin e propozimit votuan anëtarët **Saida Dollani** dhe **Ludovik Dodaj**.

Me rezultatin e votimit 7 vota pro dhe 2 kundër, ky propozim miratohet me riformulimet e sipërcituara.

Këshilli vijon punimet me shqyrtimin dhe diskutimin në lidhje me përmbajtjen e nenit 4 të projektvendimit për shtesën e një fjalie në pikën 20 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*.

Marsida Xhaferllari, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet thelbin e motiveve për propozimin e dispozitës së nenit 4 të projektvendimit për shtesën e një fjalie në pikën 20 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Anëtarët e Këshillit, diskutojnë dhe parashtrojnë argumentet e tyre në lidhje me propozimin e paraqitura për shtesën e një fjale në pikën 20 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Erinda Ballanca, merr fjalën dhe parashtron se nga praktika se si ka ecur puna vitin e kaluar rezulton që ky është një veprim që duhet të kryhet pasi hetimi në të vërtetë kryet nga ana e relatorit. Kjo është qartë pavarësisht se si përcillet tek të tretët sigurisht nëpërmjet firmës së kryetarit. Por do të duhet që çdo informacion dhe çdo përgjigje që kthehet të dërgohet tek relatori. Ne kemi pasur një problem vjet, ndoshta duhet ta shikojmë pak edhe këtë z. Kryetar, po ta kujtoni, që relacionet përfundimtare në disa raste dështuan tua dërgonim individëve...

Ardian Dvorani, ndërhyt dhe sqaron se jo në disa raste, është vetëm një rast.

Erinda Ballanca, merr fjalën dhe vijon duke parashtruar se në disa raste i kemi çuar brenda ditës. Kemi pasur disa probleme për disa faktorë. Ishte totalisht rastësi, por në një rast nuk ia dolëm t'ia dërgonim dhe ndaj patëm një problem në gjykatë. Prandaj është e rëndësishme që dhe hallkat procedurale, pra kush e ka marrë vendimin ti dërgohet, kush ka marrë vendimin të procedohet me dërgimin dhe kush se ka kryer pastaj përfundimisht që, praktikisht ka qenë këshilltari që do të duhet të bëhet komunikimin me individin, të gjithë këta duhet të identifikohen në mënyrë të qartë. Kemi pasur disa raste që kanë qenë të pasaktë, eventualisht të pakoordinuar. Ky është një saktësim procedural pozitiv.

Katrin Treska merr fjalën dhe parashtron se e shpreha qëndrimin kur u bë i njëjti diskutim në projektvendimin e parë. Rregullat e punës dhe dokumentet në autoritete publike janë tashmë të njehsuara. Madje konfirmimet elektronike nuk njihen. Kështu që do të ishim për propozimin siç është paraqitur, përmes nënshkrimit apo siglimit.

Agnes Berhard (përkthen përkthyesja), merr fjalën dhe shprehet se nuk ka asnjë koment.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve, për propozimin e dispozitës së nenit 4 të projektvendimit për shtesën e një fjalie në pikën 20 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë:

Për miratimin e propozimit si pikë 20/1 me këto riformulime:

“20/1. Kur akti apo shkresa e komunikimit për mbledhjen e të dhënave nga të tretët nënshkruhet nga Kryetari, atëherë përmbajtja e aktit apo e shkresës konfirmohet paraprakisht përmes nënshkrimit/siglimit ose postës elektronike nga relatori përkatës, praktikë e cila vendoset në dosjen e kandidatit.”,

votuan anëtarët **Ardian Dvorani**, **Vitore Tusha**, **Fiona Papajorgji**, **Arta Marku**, **Miranda Andoni**, **Ludovik Dodaj**, **Fatjona Memçaj** dhe **Arjan Qafa**.

Për mosmiratimin e propozimit votoi anëtarja **Saida Dollani**.

Me rezultatin e votimit 8 vota pro dhe 1 kundër, ky propozim miratohet me riformulimet e sipërcituara.

Këshilli vijon punimet me shqyrtimin dhe diskutimin në lidhje me përmbajtjen e nenit 5 të projektvendimit për shtesën e një pike 20/1 në vendimin nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Marsida Xhaferllari, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet thelbin e motiveve për propozimin e dispozitës së nenit 5 të projektvendimit për shtesën e një pike 20/1 në vendimin nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Anëtarët e Këshillit, diskutojnë dhe parashtrojnë argumentet e tyre në lidhje me propozimin e paraqitura për shtesën e një pike 20/1 në vendimin nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Erinda Ballanca, merr fjalën dhe parashtron se së pari garantoj që Avokati i Popullit ka mjaftueshëm punë për verifikimin e ankesave të gjithkujt dhe nuk më vjen fare me dëshirë që të verifikoj edhe ankesat ndaj Këshillit. Kjo, së pari. Garantoj gjithashtu që nëse relatorët kanë për ta parë vetëm dosjen e tyre, Avokati i Popullit ka parë dosjet e të gjithëve, nga fillimi deri në fund. Pse? Për shkak se ia ka dhënë këtë detyrë ligji. Unë vetë nuk kam as edhe një dëshirë që të rri dhe të shikoj dosjet e njerëzve të tjerë dhe për më tepër ti hyj jetës së tyre personale nga fillimi deri në fund. Kjo është një gjë që e bëj për shkak të ligjit. A do ta bëj punën mirë apo a do ta bëj punën çka, këtë mund ta vlerësojë publiku, mund ta vlerësojmë edhe njëri tjetrin, mund ti tregojmë secilit një standard më të mirë të bërjes së punës. Ajo që unë shikoj në propozim është se ankesën e individit ia komunikon Avokatit të Popullit. Nuk po diskutojmë vendimmarrjen. Mund të mos shkojë fare në vendimmarrjen e Këshillit kjo çështje sepse janë veprimet që bëhen nga relatori dhe Avokati i Popullit, sipas ligjit, merr pjesë pa cilësimin vëzhgues në mbledhje dhe në veprimtari. Pra, kjo është një pjesë e veprimtarisë që, mbi bazën e një ankese gjithmonë të individit, jo mbi bazën e veprimit tim, mundet të më vijë në vëmendje, ende pa u shqyrtuar nga këshilli. Po diskutojmë për një element procedural që nuk duam ta lodhim Këshillin. Po diskutojmë, a është kryer apo jo në mënyrë të duhur një procedurë verifikimi në dijeninë e kandidatit. Kjo është marrëdhënia. Kështu që duke dhënë parantezën se nuk kam asnjë dëshirë për ti shtuar vetes time punë, të pa paguar, e saktësoj këtë, mund ta bëj këtë gjë. Mund ta jetoj jetën time shumë mirë pa marrë pjesë në këto mbledhje dhe pa qenë këtu. A duhet tu krijohet njerëzve garanci që nëse ka ndonjë problem të jenë në dijeni se ku mund të ankohen. Nuk kemi dhënë garanci maksimale për vendimmarrjen, nuk e ka dhënë ligjvënësi, por për procedurat deri në

vendimmarrje a mundet dhe a duhet të japë apo nuk duhet të japim. Nëse ju vendosni që nuk duhet të japim, nuk ua japim. Por nuk është fare vetëdenoncim dhe nuk është tek Këshilli. Ju do ta shikoni vetë sesa faqe, mijëra faqe duhet të lexoni për dosjet. Pavarësisht se dosjet i bën relatori është përgjegjësi e gjithë Këshillit votimi i materialeve dhe i çdo gjëje tjetër. Nuk kalohet vetëm me diskutimin apo me ato që ka parë relatori sepse këshilli vetë ka për ta parë se sa e rëndësishme është çështja. Kështu që për mua është një garanci shtesë për kandidatin. Nëse ju e konsideroni që kandidati e ka të mjaftueshëm garancinë në këtë proces, mund të mos e miratoni. Nëse mendoni që këta kandidatë nuk kanë garanci të mjaftueshme, mund ta miratoni.

Agnes Berhard (përkthen përkthyesja), merr fjalën dhe shprehet se e kam pak të vështirë ta interpretoj situatën që propozohet dhe kur vjen puna tek parregullsitë në procedimet e Këshillit që tregohet në fjalinë e fundit të dispozitës së propozuar, shikoj si organin kompetent për trajtimin e tyre ose Gjykatën ose Prokurorinë.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve, për propozimin e shtesës së një pike 20/1 në vendimin nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për mosmiratimin e propozimit **votuan të gjithë anëtarët e Këshillit**.

Këshilli vijon punimet me shqyrtimin dhe diskutimin në lidhje me përmbajtjen e nenit 6 të projektvendimit për shtesën e fjalëve “dhe të Avokatit të Popullit” në fund të pikës 41 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Marsida Xhaferllari, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet thelbin e motiveve për propozimin e dispozitës së nenit 6 të projektvendimit për shtesën e fjalëve “dhe të Avokatit të Popullit” në fund të pikës 41 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Anëtarët e Këshillit, diskutojnë dhe parashetrojnë argumentet e tyre në lidhje me propozimin e paraqitur për shtesën e fjalëve “dhe të Avokatit të Popullit” në fund të pikës 41 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pas këshillimit me pjesëmarrësit, për shkak edhe të nevojave të teknikës së regjistrimit audio të punimeve të mbledhjes, cakton 15 minuta pushim.

PJESA E TRETË E MBLEDHJES

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pas pushimit, orienton vijimin e diskutimit të deritanishëm në lidhje me propozimin e paraqitur për shtesën e fjalëve “dhe të Avokatit të Popullit” në fund të pikës 41 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Anëtarët e Këshillit, vijojnë të diskutojnë dhe parashtronë argumentet e tyre në lidhje me propozimin e paraqitur për shtesën e fjalëve “dhe të Avokatit të Popullit” në fund të pikës 41 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Erinda Ballanca, merr fjalën dhe parashtron se Kushtetua dhe ligji i jep Avokatit të Popullit të drejtën për të marrë pjesë në mbledhjet e mbyllura të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe në këtë pikë nuk ka mbyllje përtej mbylljes. Nuk ka dhe më bëri shumë çudi të dëgjoj që ekzistenca e dhomës së këshillimit të pranohet si një fakt procedural i miratuar për organet kolegjiale. Jo, dhoma e Këshillimit është një element tërësisht procedural gjyqësor. Nuk jemi duke funksionuar në asnjë moment në këtë organ si gjykatat. Për shkak të besimit se një pjesë e mirë janë gjyqtarë në këtë mbledhje dhe mendojnë se e njëjta sjellje duhet të jetë organet administrative sjellin edhe këto lloj rezultatesh. Është shumë e qartë, që ligji në nenin “Transparenca”, pra, sa mundet të jetë transparenca që duhet të bëj ky Këshill, ka parashikuar pjesëmarrjen e Avokatit të Popullit dhe përcakton se mbledhjet janë të mbyllura. Në anglisht që të jemi të qartë tek draftuesit është *Meetings are held in camera*, në versionin anglisht. Pra, kjo konsiderohet dhoma e këshillimit. Nuk ka një dhomë këshillimi pas dhomës së parë të këshillimit. Pas kësaj menjëherë në nenin 233 vjen fjala “Avokati i Popullit” merr pjesë në mbledhje dhe në veprimtarinë e Këshillit. Pra, ka pjesëmarrje në mbledhje, ka edhe pjesëmarrje në veprimtari. Ne me një akt nënligjor e përjashtojmë. Ju mendoni se nuk e përjashtoni. Sigurisht kjo mund të jetë mendimi juaj. Por, ligji thotë se Avokati i Popullit merr pjesë në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit. Nëse Këshilli gjatë votimit nuk kryen mbledhje dhe veprimtari, unë nuk marr pjesë. Nëse Këshilli në fakt, veprimtarinë e vet e ka pikërisht verifikimin dhe renditjen e kandidatëve, unë nuk mund të jem e përjashtuar në kuptim të ligjit, jo në kuptim të vullnetit dhe dëshirës time. Për të kaluar përsëri tek diskutimi i fjalës së vëzhguesit. Kushtetuta parashikon “*merr pjesë në cilësinë e vëzhguesit në short, si dhe në mbledhje dhe në veprimtari*”. Interpretimi mund të jetë në dy mënyra. Pra që pozicioni i Avokatit të Popullit është vëzhgues në të gjitha pjesëmarrjet, por dhe në short. Unë marr pjesë gjatë gjithë kohës së shortit, nuk ka ndonjë pjesë shorti ku nuk marr pjesë. Ose është vëzhgues në pjesën e shortit dhe është pjesëmarrës në mbledhje dhe në veprimtari të KED-së. Në fakt ky nuk ka qenë një interpretim që e kam bërë unë në vetë të parë. Ka qenë një interpretim të cilin e ka bërë Këshilli. Pra, Kushtetuta ka një parashikim, nenin 149/d ku

është vetëm një fjali. Kur ligji e rimerr pozicionin e Avokatit të Popullit, e rimerr në dy vende të ndryshme. E citon fjalën vëzhgues përsëri në pjesëmarrjen në shortin e anëtarëve të KED-së dhe nuk e përmend më termin vëzhgues në pjesën e nenit 233 ku përcakton qartësisht se “*Avokati i Popullit merr pjesë në mbledhje dhe veprimtari*”. Nëse ka ndonjë moment tjetër në të cilin ky Këshill nuk bën mbledhje dhe veprimtari, unë jam dakord që të largohem. Në të kundërt vendimet merren pikërisht në mbledhje. Ekzistenca e dhomës së këshillimit nuk mund të merret një fakt i mirëqenë në këtë organ. Më vjen keq se një pjesë nga anëtarët e pranojnë këtë si një fakt i mirëqenë, për këtë organ. Nuk e parashikohet dhomë këshillimi përtej dhomës së këshillimit. Vetë fakti që është e shkruar në nenin “Transparenca” tregon çfarë transparence minimale duhet të bëj ky Këshill. Ashtu siç ligji përcakton se duhet ti ruajmë të dhënat e individëve dhe të gjithë gjërat e tjera. Por detyrimin për transparencën e Këshillit nuk mund ta lexojmë si mospjesëmarrje të Avokatit të Popullit gjatë gjithë veprimtarisë. Ideja e bisedimeve dhe, për hir të së vërtetës, terminologjia është zbardhur “bisedime” por është diskutuar gjatë gjithë kohës si dhomë këshillimi, por kjo është një teknikë legjislative shumë pozitive për të mos thënë që nuk merr pjesë, po që mbledhja bëhet vetëm nga këta. Është një mënyrë e zbutur për të treguar përjashtimin. Versioni anglisht është jashtëzakonisht i qartë sepse nga anglishtja ka ardhur. Termi është *are held in camera*. Kjo është dhoma e këshillimit.

Tjetra për çfarë u bë gjithë kjo Reformë në Drejtësi? Të gjithëve na quanin se ishim pjesë korporativizmit. Merrnim vendime njëri me tjetrin, sipas dëshirës tonë, pa asnjë lloj transparence. Ky ishte problem thelbësor. Ne nuk besojmë që ky Këshill dhe unë dua të besoj që ky këshill nuk është i kapur politikisht. Nuk kam arsye që ta besoj. Ne do të duhet të bëjmë punën tonë profesionalisht dhe duhet ta tregojmë të gjithë me vepra dhe me veprime se a ka vend për ta mbyllur më tepër këshillin nga çfarë është i mbyllur? Kjo mua më duket e çuditshme përtej deklaratave që të gjithë anëtarët e këshillit besojnë që do të ishte mirë që Këshilli të ishte i hapur. Të paktën anëtarët e vitit të kaluar. Këtë bindje që kemi për mbledhje të hapura nuk mundet ta kufizojmë edhe më tepër për personat të cilëve ligji jua njeh qartësisht të drejtën për të marrë pjesë.

Kthehem tek diskutimi i opinionit të Komisionit të Venecias. Avokati i Popullit nuk ka qenë në draftin në të cilin ka pasur Komisioni i Venecias si anëtar apo vëzhgues i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Versioni i parë në Komisionin e Venecias, kur ka ardhur me komente ka ndryshuar komplet konceptin, ka ndryshuar që të mos jenë mbledhjet e hapura por të jenë të mbyllura, por mund të jetë vëzhgues edhe Avokati i Popullit. Kjo ka qenë përpara se të bëheshin ndryshimet ligjore. Opinioni i Komisionit të Venecias nuk ka thënë të

mos marrë pjesë Avokati i Popullit. E kundërta, vetë ligjvënësi, pasi ka marrë opinionin e Komisionit të Venecias, ka draftuar versionin përfundimtar të ligjit. Pra, ky nuk është opinionin për ligjin e përfunduar por për draftin në të cilin parashikoheshin garancitë përkatëse. Ligjvënësi eventualisht e ka menduar që pjesëmarrësja e Avokatit të Popullit mund të ishte më e vlefshme se ajo që ka dhënë Komisioni i Venecias. Ky Komision ka thënë të konsiderohet kjo, ligjvënësit kanë thënë po të jetë pjesëmarrëse në mbledhje dhe në veprimtari. Nuk mund të interpretohet opinionin i Komisionit të Venecias si një qëndrim që duhet të ketë zero transparencë në një pjesë të mbledhjes dhe të vendimmarrjes. Jam shumë të bëni ju propozim për ta ndryshuar ligjin sepse nuk është se kam ndonjë merak të veçantë. Avokati i Popullit, në natyrën e vet, ka kompetencë monitoruese për çdo proces i cili mund të krijojë problematika në zbatimin e të drejtave të njeriut dhe sigurisht që këtu nuk kemi as praninë e kandidatëve. Mbledhjet janë të mbyllura. Nuk ka vëzhgim të askujt, përveç vetes tonë dhe ne duhet tu krijojmë mundësinë për të paktën një lloj transparence që duhet bërë në punën tonë. Në fakt, unë jam e bindur që Këshilli ka bërë një punë të jashtëzakonshme, shumë të mirë në vitin e kaluar, deri në atë të përfundimit të procesit, i cili, në gjykimin tim, nuk ishte ashtu siç ishte gjatë gjithë ecursisë së punës së tij dhe solli ato probleme që solli, duke ulur dhe minuar besimin e publikut tek reforma në përgjithësi.

Në gjykimin e Avokatit të Popullit, në çdo pjesë në nenin “Transparenca”, pika 1, është e qartë prezenca ime për efekt të transparencës. Nëse ju mendoni që nuk duhet të jetë, e kam thënë me qindra herë që s’kam asnjë merak të madh për të qenë, por e kam të pamundur që një kompetencë që mua ma jep Kushtetuta dhe Ligji të pranoj ta heqin me një akt nënligjor. Nëse pjesëmarrja në mbledhje në rregulloren e parë ka qenë, kemi bërë dhe debat atje, por ka qenë e garantuar, në rregulloren e dytë thotë se nuk duhet të jetë. Atëherë për çfarë jam unë pjesëmarrëse? Jam pjesëmarrëse tek vendimmarrja për të bërë rregullat, jam vëzhguese se si do ti bëjë rregullat Këshilli apo jam vëzhguese se si do ta zbatoj Këshilli pa transparencë ligjin dhe kriteret e njëjta për të njëjtët kandidatë. Besoj se këto i kam thënë edhe në padi, ju e keni parë padinë. Dua t’ua bëj më dije që kam pritur që të mbaroj procesi sepse unë nuk kam dashur që të ngre zërin për të minuar vlerën e procesit apo vullnetin apo besimin e qytetarëve tek ky proces. E kam sjellë disa herë në vëmendje të Këshillit edhe për të kuptuar pozicionin dhe qëndrimin, besoja dhe gjithmonë vazhdoj të besoj se garancitë që janë parashikuar në ligj për kandidatët ne duhet të mundohemi ti japim.

Katrin Treska merr fjalën dhe parashtron se qëndrimi i Institucionit të Presidentit është shprehur edhe në mbledhjen e kaluar nga përfaqësuesi. M, megjithatë vlen që ta theksoj edhe njëherë që propozimi i sjell përmes projektaktit është një mundësi shumë e mirë, nëse

votohet, për ta sjellë rregulloren në përputhje me parashikimet e ligjit dhe të Kushtetutës. Më herët në këtë mbledhje kur u diskutua roli i vëzhguesit të Avokatit të Popullit dhe znj. Bernhard, përmendi diçka që më ngeli në mendje. Nuk ka një definicion që çfarë mund të bëjë një vëzhgues ose jo? Mbase nuk e ka. Por në rastin konkret ne po diskutojmë pjesëmarrjen e Avokatit të Popullit në mbledhje të Këshillit që ia ka garantuar Kushtetuta dhe që është transpozuar i njëjti parashikim edhe në ligj. Përveç kushtetutshmërisë që për mua s'ka më asnjë diskutim dhe as që mund ta ngrejë si çështje, për kuriozitet duke përfutur nga pushimi më parë, hapa pak fjalorin e gjuhës shqipe dhe doja të shikoja kush është kuptimi i pjesëmarrjes në një veprimtari. Do të thotë të jesh i pranishëm në bërjen e një vepre apo pune, sipas fjalorit të gjuhës shqipe. Veprat dhe puna e vendimit e KED është dalja me një vendim përfundimtar dhe nuk mund të eliminohet pjesëmarrja i Avokatit të Popullit si garant i gjithë procesit nga bisedimet apo nga votimit sepse ato janë pjesë e gjithë vendimmarrjes së Këshillit.

Agnes Bernhard (përkthen përkthyesja), merr fjalën dhe shprehet se e kam shprehur mendimin tim në lidhje me rolin e Avokatit të Popullit dhe mbaj të njëjtin mendim.

Erinda Ballanca, merr fjalën dhe e pyet në versionin anglisht që unë citova fjala “*in camera*” a i referohet dhomës së këshillimit?

Agnes Bernhard, merr fjalën dhe lexon në anglisht tekstin e pikës 1 të nenit 233 të ligjit nr. 115/2016.

Anëtarë të Këshillit, diskutojnë dhe parashtrajnë edhe argumente të tjera në lidhje me propozimin e paraqitur për shtesën e fjalëve “dhe të Avokatit të Popullit” në fund të pikës 41 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Erinda Ballanca, merr fjalën dhe parashtron se ligj thotë për sa kohë nuk është e parashikuar, këtu mundet ti referohemi ligjit për organet kolegjiale për veprimtarinë e organeve kolegjiale. Dhe këtu ka parashikim, në gjykimin tim, shumë qartë për transparencën e pjesshme që zhvillohet në këtë proces. Për sa i përket faktit, kjo që ju thoni se Avokati i Popullit, mund të jetë kur bëhen rregulloret se kanë karakter të përgjithshëm dhe nuk është kur bëhet vlerësimi, duke thënë votimi është diçka që nuk është mbledhje, për mua kjo më duket.... Ju mund të merrni vendime si të doni, diskutimi është a është kjo vendimmarrje e cila cenon transparencën e këtij Këshilli, që tashmë është e tillë dhe a është legjitim krijimi i një dhome këshillimi në dhomën e këshillimit? Ky këshill ka qenë edhe për rregulloren të mos të merrnim pjesë. Ka pasur edhe aty debat. Unë e mendoj kështu dhe nuk kam pse të mërzitem me një njeri që e mendon në mënyrë tjetër. Mua më takon nga pikëpamja ime që të

bëj mbrojtjen e institucionit, të asaj që Kushtetuta dhe Ligji i ka dhënë institucionit të Avokatit të Popullit dhe jo Erinda Ballancës dhe kjo është besoj shumë e qartë.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve, për propozimin e paraqitur për shtesën e fjalëve “dhe të Avokatit të Popullit” në fund të pikës 41 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për miratimin e propozimit votuan anëtarët *Arta Marku* dhe *Nezir Gjoka*. Për mosmiratimin e propozimit votuan anëtarët *Ardian Dvorani, Vitore Tusha, Fiona Papajorgji, Miranda Andoni, Saida Dollani, Ludovik Dodaj* dhe *Arjan Qafa*. Me rezultatin e votimit 2 vota pro dhe 7 kundër, ky propozim nuk miratohet.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pas marrjes së mendimit të pjesëmarrësve në mbledhje, me dakordësinë e anëtarëve të Këshillit, deklaron të mbyllur mbledhjen dhe caktimin e mbledhjes së radhës në datën 06.02.2020, në orën 15.00, për të vijuar punimet me të njëjtin rend dite.

MBYLLET MBLEDHJA NË ORËN 19.35

SEKRETARE

Ermelinda KADIU

Dorina DULAJ

Elona KARDHIQI

Fabjola MUHAMETI

Vilma DOKUSHI

KRYETAR

Ardian DVORANI